Kronikë

Armë pa leje, tre të arrestuar në Durrës! Dy prej tyre nga Lezha, dyshohet se do të shisnin një pistoletë në qytetin bregdetar

Tre persona kanë rënë në prangat e policisë së Durrësit për armëmbajtje pa leje.

Arma dhe municion luftarak e sekuestruar nga Policia

Redaksia
10 Qershor, 13:51 | **Përditesimi: 10 Qershor, 14:13**

Share Post

Durrës-Tre persona kanë rënë në prangat e policisë së Durrësit për armëmbajtje pa leje.

Gjatë këtij operacioni bluteë e Durrësit bëjnë me dije se dy prej tyre, Lamberto Dinaj dhe Arsildo Marku u arrestuan duke lëvizur me automjet, në hyrje të qytetit.

Dyshohet se ata do të shisnin një pistoletë me 2 krehra dhe fishekë. Arma e zjarrit, municioni dhe një sasi kanabisi u gjetën në çantën e pasagjerit.

"Si rezultat i intensifikimit të kontrolleve dhe punës operative, me objektiv identifikimin dhe ndalimin e shtetasve që përbëjnë rrezik për sigurinë publike, duke poseduar ose shitur armë zjarri, me qëllim kryerjen e ngjarjeve kriminale, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Komisariati i Policisë Shijak, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, finalizuan operacionin e koduar "Kalibri".

Gjatë operacionit u arrestuan shtetasit:

-L. D., dhe A. M., të dy banues në Lezhë, të cilët u kapën duke lëvizur me automjet, në hyrje të qytetit të Durrësit, dyshohet për të shitur një armë zjarri (pistoletë) me 2 krehra dhe fishekë. Arma dhe municioni u gjetën në çantën e pasagjerit, shtetasit L. D., të cilit iu gjet dhe një sasi e vogël lëndë e dyshuar narkotike Cannabis Sativa", njoftoi sot policia.

Ndërkohë në fshatin Shtrazë, Shijak, bluteë gjetën në banesën e Dervish Tushës një kallashnikov, 1 granatë mbrojtëse, 1 krehër arme dhe qindra fishekë luftarak.

"D. T., pasi gjatë kontrolleve në banesë në fshatin Shtrazë, Shijak, iu gjetën 1 armë zjarri (kallashnikov), 1 granatë mbrojtëse (me ndezës të montuar), 1 krehër arme dhe qindra fishekë luftarak, që posedoheshin pa leje", thuhet më tej në njoftim.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Dervish Tusha | Arsildo Marku | Lamberto Dinaj | Durres | armembajtje pa leje

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A e mbështetsni protestën kundër investimit në Zvërnec?
6 Qershor, 21:08
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

'Anuloni projektin TID', banorët protestë para Bashkisë së Durrësit: Po na vidhni pronat! Sako: Objektet do të rivlerësohen

Artur Korriku

12 Qershor, 12:46

Durrës, protesta 'tremb' turistët, bie numri i rezervimeve, operatorët: Ministria të negociojë me agjencitë e huaja

Artur Korriku

12 Qershor, 12:11

Kontrabandë diamantesh në Portin e Durrësit me vlerë 4400 euro në total, ndalohet 30-vjeçari, erdhi nga Ankona (EMRI)

11 Qershor, 08:32

Kontrolle masive të makinave të ardhur nga Italia, kokainë, diamante dhe pajisje për zbulimin e metaleve të çmuara, ja çfarë u kap sot në Portin e Durrësit

10 Qershor, 17:33

Policia operacion në Vlorë, arrestohen 6 persona dhe shpallen në kërkim 3 të tjerë

8 Qershor, 20:01

Menaxhimi i trafikut gjatë sezonit veror, drejtori i Policisë Durrës: Po monitorojmë me pajisje inteligjente! Në fokus edhe siguria në plazhe

8 Qershor, 12:43

Durrës/ Hiqen gurë nga muret antike, arkeologia ngre alarmin: Fëmijët s'duhet të luajnë me historinë 1500-vjeçare të Forumit Bizantin (VIDEO)

Aldo Mustafa

8 Qershor, 11:41

Plagosja me armë zjarri në Shijak, arrestohet autori! Policia e Durrësit: Nuk bëri rezistencë

8 Qershor, 11:22



Plagoset me armë zjarri një person në Shijak, Policia në kërkim të autorit (EMRAT)

7 Qershor, 19:48

Shiste drogë mes lojërave elektronike, në pranga 20-vjeçari në Durrës

7 Qershor, 12:57

Mbi 2000 motoristë në 'Moto Fest 5', Shijaku kthehet në qytetin e motorëve dhe muzikës 'Rock' (VIDEO)

Aldo Mustafa

6 Qershor, 16:53

Spilleja gati për sezonin veror, Balla: Turizmi mbetet motori i zhvillimit të zonës

6 Qershor, 15:36

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje